



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 94

Tiranë – E hënë, 26 qershor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 367, datë 16.6.2023	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Kukës, z. Safet Gjici.....	10057
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 359, datë 14.6.2023	Për miratimin e procedurës së marrjes së mostrave.....	10057
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 467/8, datë 23.6.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës lidhëse Pogradec–Doganë, loti 2”.....	10104

**VENDIM****Nr. 367, datë 16.6.2023****PËR SHKARKIMIN
NGA DETYRA TE KRYETARIT
TË BASHKISË KUKËS, Z. SAFET GJICI**

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës, dhe të shkronjës “a”, të nenit 62, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkak të shkeljeve të rënda, të kryetarit të Bashkisë Kukës, z. Safet Gjici.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR**Nr. 359, datë 14.6.2023****PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË
MARRJES SË MOSTRAVE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 8, të nenit 7, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e procedurës së marrjes së mostrave për shëndetin e bimëve dhe produktet e mbrojtjes së bimëve, si më poshtë:

KREU I**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****1. Fusha e zbatimit**

Procedura e marrjes së mostrës zbatohet nga institucionet përgjegjëse për marrjen e mostrave në kontrollet zyrtare, për:

- testimin e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera për pastërtinë fitosanitare;
- zbulimin e dëmtuesve karantinor;

- monitorimin dhe vrojtimin për situatën fitosanitare në vend nga dëmtuesit;

- testimin për kontrollin cilësor të PMB-ve të regjistruara dhe të hedhura në treg.

2. Përkufizimet

Për qëllim të këtij urdhri termat e përcaktuar në nenin 2, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar dhe urdhrin nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim.

Ndërsa, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Infeksion i fshehtë” është infektimi nga dëmtuesi (p.sh. bakteret dhe viruset etj.) pa shfaqur asnjë simptomë të dukshme;

b) “Madhësia e mostrës” është numri i njërive të zgjedhura nga loti ose ngarkesa që do të inspektohet ose testohet (provë);

c) “Objekt për inspektim fitosanitar” është ngarkesa në import, në eksport me bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera dhe bima, bima e mbjellë dhe plantacioni, për inspektim fitosanitar;

ç) “Rastësisht” është procedura e marrjes së mostrës në mënyrë rastësore;

d) “Testim” është analizimi laboratorik, si dhe prova fushore dhe/ose laboratorike e mostrës.

3. Përmbledhja e kërkesave

Metodologjitë e mostrimit që do përdoren nga institucionet përgjegjëse në zgjedhjen e mostrave për inspektim, bazohen në një numër konceptesh të marrjes së mostrave. Kjo përfshin parametra të tillë si:

- niveli i pranimit;
- niveli i zbulimit;
- niveli i besueshmërisë;
- efikasiteti i zbulimit; dhe
- madhësia e mostrës.

Zbatimi i metodave bazuar statistikisht për zbatim, që ofrojnë rezultate me një nivel besueshmërie statistikore, janë të përcaktuara si më poshtë:

- mostrim i thjeshtë i rastësishëm;
- mostrim sistematik;
- mostrim të shtresëzuar;
- mostrim vijues;
- mostrim në grupe;
- mostrim me proporcion fiks.

Metoda të tjera të marrjes së mostrave që nuk janë të bazuara statistikisht, mund të sigurojnë



rezultate të vlefshme në përcaktimin e pranisë ose mungesës të një dëmtuesi të rregulluar, por nuk mund të nxirren përfundime statistikore në bazë të tyre. Këto metoda janë si më poshtë:

- mostrim i përshtatshëm;
- mostrim gjysmërastësor; ose
- mostrim përzgjedhës.

Ngarkesa mund të përbëhet nga një ose shumë mallra, kur një ngarkesë përmban më shumë se një mall, inspektimi për të përcaktuar përputhshmërinë duhet të përbëhet nga disa ekzaminime vizuale.

KREU II PROCEDURA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR SHËNDETIN E BIMËVE

SEKSIONI I UDHËZIME PËR INSPEKTIM

1. Objektivat e inspektimit

Objekti i inspektimit të ngarkesave është konfirmimi i përputhshmërisë së ngarkesave të importit ose eksportit lidhur me kërkesat mbi dëmtuesit karantinor ose dëmtuesit jokarantinorë të rregulluar. Inspektimi gjithashtu kryhet për verifikimin e efektivitetit të masave të tjera fitosanitare të zbatuara në vendin e dërgimit të ngarkesës.

Inspektimi i ngarkesave:

- për eksport, shërben për të siguruar që ngarkesa plotëson kërkesat e legjislacionit vendës si dhe kërkesat fitosanitare shtesë që aplikohen në vendin importues. Pas inspektimit lëshohet certifikatë fitosanitare për eksport sipas nenit 13, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”;

- në import, shërben për të verifikuar përputhjen me kërkesat fitosanitare, sipas ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Inspektimi shërben, gjithashtu, për zbulimin e dëmtuesve për të cilët risku fitosanitar nuk është përcaktuar ende.

Ndërsa inspektimi fitosanitar i bimëve të mbjella apo plantacioneve me bimë shërben për:

- mbrojtjen e tyre kundër dëmtuesve;
- zbulimin e dëmtuesve karantinor apo dëmtuesve të rinj, për të cilët nuk është përcaktuar risku fitosanitar;

- reduktimin e humbjeve të prodhimit nga dëmtuesit; dhe

- qëllime të tjera monitoruese dhe vrojtuese për dëmtues të ndryshëm.

Rezultatet e inspektimeve fitosanitare do të shërbejnë për hartimin e planeve të kontrollit zyrtar bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut.

2. Procedura që ndiqet në inspektim

Procedura e inspektimit të zbatohet për të zbuluar praninë e dëmtuesve ose për të përcaktuar ose verifikuar incidencën e dëmtuesve në një ngarkesë dhe bazohet në, po jo vetëm:

- dëmtuesit kyç, sipas natyrës së ngarkesës, shenjat ose simptomat që ato shkaktojnë;
- inspektimin praktik në aspektin operacional;
- njohjen e probabilitetit që dëmtuesit nuk janë të pranishëm.

Ekziston një probabilitet që dëmtuesit të mos zbulohen kur kryhet inspektimi, kjo ndodh sepse inspektimi zakonisht bazohet në marrjen e mostrës, e cila mund të mos përfshijë ekzaminimin vizual 100% të lotit ose ngarkesës dhe, gjithashtu, sepse inspektimi nuk është 100% efektiv për zbulimin e një dëmtuesi të specifikuar në ngarkesën ose mostrat e kontrolluara. Kur inspektimi përdoret si një procedurë e menaxhimit të riskut, ekziston probabiliteti që një dëmtues që është i pranishëm në një ngarkesë ose lot, të mos zbulohet.

Madhësia e një mostre për qëllime inspektimi përcaktohet normalisht në bazë të një dëmtuesi të rregulluar të specifikuar, të lidhur me një mall/produkt specifik. Mund të jetë më e vështirë të përcaktohet madhësia e mostrës në rastet kur inspektimi i ngarkesave ka për qëllim disa ose të gjithë dëmtuesit e rregulluar.

3. Institucionet përgjegjëse dhe pajisjet e domosdoshme që rekomandohen për inspektim

Institucionet përgjegjëse për inspektim janë institucionet të përcaktuara sipas nenit 4, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

Për të rritur shkallën e besueshmërisë të një ekzaminimi vizual dhe të zgjedhjes së një mostre për testim, inspektorit fitosanitar i nevojiten pajisjet minimale të përcaktuara në aneksin I, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Kërkesat për inspektorët

Detyrimet e inspektorit në procedurat e kontrollit zyrtar, janë si më poshtë:



- autorizim për të përmbushur detyrat e tyre dhe përgjegjshmërinë për veprimet e tyre;

- kualifikimet teknike, veçanërisht në zbulimin e dëmtuesve;

- njohuri për identifikimin e dëmtuesit, bimëve dhe produkteve bimore dhe artikujt e tjerë të rregulluar;

- mjetet dhe pajisjet e duhura për inspektim;

- udhëzime me shkrim (siç janë rregulloret, manualët, udhëzues për dëmtuesit);

- njohuri për funksionet e institucioneve të tjera rregullatore, kur është e nevojshme;

- objektivitetin dhe paanshmërinë.

Inspektori inspekton ngarkesat për:

- përputhshmërinë e kërkesave të legjislacionit në import ose në eksport;

- dëmtuesit e specifikuar;

- organizmat për të cilët nuk është përcaktuar ende risku fitosanitar.

5. Faktorë të tjerë që kërkojnë vëmendje në inspektim

Në procedurën e inspektimit për kontrollet zyrtare, inspektori do të marrë në konsideratë sipas rastit, faktorët si më poshtë:

- masat zbutëse të ndërmarra nga vendi eksportues;

- nëse inspektimi është masa e vetme ose e kombinuar me masa të tjera;

- destinacionin e ngarkesës, qëllimin e përdorimit;

- vendin/zonën e prodhimit;

- madhësinë dhe konfigurimin e ngarkesës;

- vëllimin, frekuencën dhe kohën e dërgesës;

- historikun lidhur me origjinën dhe/ose transportuesin;

- mjetet e transportit dhe ambalazhimin;

- burimet financiare dhe teknike, në dispozicion (duke përfshirë aftësitë diagnostikuese të dëmtuesve);

- trajtimin dhe përpunimin e mëparshëm;

- karakteristikat e projektimit/përcaktimit të marrjes së mostrave të nevojshme për të arritur objektivat e inspektimit;

- vështirësinë e zbulimit të dëmtuesve specifikë në një ngarkesë;

- përvojën dhe rezultatet e inspektimeve të mëparshme;

- efektivitetin e procedurës së inspektimit.

6. Kërkesat specifike për kontrollin dokumentar, identitetin dhe fizikun

Kërkesat teknike për kontrollin zyrtar përfshijnë 3 procedura të ndara, kontrollin dokumentar, kontrollin e identitetit dhe kontrollin fizik, që duhet të zbatohen sipas rastit për të garantuar kërkesat teknike dhe praktikitetin operacional, të cilat janë të përcaktuara në nenin 18, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e masave mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar.

7. Përputhshmëria me masat fitosanitare

Inspektimi përdoret për të verifikuar përputhshmërinë me masat fitosanitare në fuqi, p.sh. përfshijnë:

- trajtimin;

- shkallën e përpunimit;

- pastërtinë nga ndotësit (p.sh. gjethë); dhe

- fazën e kërkuar të rritjes, shumëllojshmërinë, ngjyrën, moshën, shkallën e pjekjes etj.;

- mungesën e bimëve të paautorizuara, produkteve bimore ose artikujve të tjerë të rregulluar;

- ambalazhimin e ngarkesës dhe kërkesat e transportit;

- origjinën e ngarkesës ose lotit;

- pikën e hyrjes.

8. Metodatat e inspektimit

Metoda e inspektimit duhet të jetë e përcaktuar ose për të zbuluar dëmtuesit e specifikuar ose për objektin për inspektim fitosanitar që inspektohet ose të përdoret për një inspektim të përgjithshëm për dëmtuesit për të cilët nuk është përcaktuar ende risku fitosanitar. Inspektori ekzaminon vizualisht njësitë në mostër derisa objektivi ose dëmtuesi të jetë zbuluar ose të gjitha njësitë e mostrës janë kontrolluar. Pas kësaj, inspektimi mund të përfundojë. Mund të kontrollohen njësi shtesë të mostrës nëse inspektorit i nevojitet të mbledhë informacione shtesë në lidhje me dëmtuesit dhe mallin, p.sh. nëse dëmtuesi nuk është hasur, por janë shenjat ose simptomat. Inspektori ka akses dhe në mjete të tjera jvizuale që mund të përdoren në lidhje me procesin e inspektimit.

Është e rëndësishme që:

- ekzaminimi i mostrës të bëhet sa më shpejt të jetë e arsyeshme dhe mostra të jetë përfaqësues i ngarkesës ose lotit;

- teknikat rishikohen për të marrë parasysh përvojën e fituar me teknikën dhe të zhvillimeve të reja teknike;

- të jenë zbatuar procedura për të garantuar pavarësinë, integritetin, gjurmueshmërinë dhe



sigurinë e mostrave për çdo ngarkesë;

- rezultatet e inspektimit të jenë të dokumentuara.

9. Rezultati i inspektimit

Rezultati i inspektimit kontribuon në vendimin që duhet të merret nëse ngarkesa përmbush rregullat fitosanitare në fuqi. Nëse përmbush rregullat fitosanitare, ngarkesa për eksport pajiset me certifikatë fitosanitare dhe ngarkesat për import lejohen të hyjnë brenda territorit të vendit.

Nëse rregullat fitosanitare nuk përmbushen, duhet të merren masa të mëtejshme sipas legjislacionit.

Në shumë raste, dëmtuesit ose simptomat që janë zbuluar mund të kërkojnë identifikim ose testime laboratorike ose ndihmën e një specialisti me provojë në këto situata. Mund të vendoset që masat emergjente janë të nevojshme kur janë gjetur dëmtues të rinj ose të panjohur më parë. Një sistem për dokumentimin dhe mirëmbajtjen e duhur të mostrave duhet të jetë i vendosur për të siguruar kthimin e ngarkesës përkatëse dhe për të lehtësuar rishikimin e mëvonshëm të rezultateve nëse është e nevojshme.

Në rastet kur janë konstatuar shkelje të përsëritura, p.sh. nga një subjekt ose vend origjine etj. duhet që frekuenca dhe shpeshësia e inspektimeve të rritet. Kur një dëmtues zbulohet në një import, raporti i inspektimit duhet të jetë i detajuar në mënyrë të mjaftueshme për të lejuar njoftime për mospërputhje.

10. Rishikimi i metodave të inspektimit

Institucionet përgjegjëse duhet të kryejnë rishikime periodike të metodave të inspektimit në import dhe eksport, për të vërtetuar përputhshmërinë me ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe aktet ligjore në zbatim të tij, për të garantuar efektivitetin e procedurës së inspektimit. Kontrollat/auditimet duhet të bëhen për të rishikuar vlefshmërinë e metodave të inspektimit. Një inspektim shtesë mund të jetë një komponent i kontrollit/auditimit.

11. Transparenca

Si pjesë e procesit të inspektimit, informacioni në lidhje me procedurat e inspektimit për një objekt inspektimi fitosanitar, duhet të dokumentohet dhe të vihet në dispozicion me kërkesë të palëve të interesuara për zbatimin e parimit të transparencës.

SEKSIONI II

MARRJA E MOSTRAVE PËR INSPEKTIMET FITOSANITARE TË NGARKESAVE NË EKSPORT DHE BIMËVE BRENDA TERRITORIT TË VENDIT

1. Marrja e mostrave të materialit bimor për qëllime laboratorike

Ekzaminimi vizual i një bime, loti ose plantacioni i bimëve të kultivuar fillon nga vlerësimi i përgjithshëm i gjithë kulturës ose i pjesës përfaqësuese të saj. Në shumë situata një ekzaminim vizual është i pranueshëm për të arritur një pasqyrë të përgjithshme të statusit fitosanitar të bimëve dhe nëse nuk vërehen simptomat apo shenja, nuk ka nevojë të merret një mostër për ekzaminim laboratorik.

Në rast të konstatimit të dyshimeve ose nëse nevojitet testim për infeksione të fshehta “latent”, duhet të merret një mostër e përshtatshme përfaqësuese. Mënyra e marrjes së mostrës dhe madhësia, do të ndryshojnë në varësi të:

- specieve të bimëve bujtëse;
- një dëmtuesi i cili dyshohet të jetë i pranishëm.

Materiali duhet të testohet duke pasur parasysh dhe qëllimin e testimit (d.m.th. ose për praninë e një dëmtuesi specifik ose për të identifikuar agjentin shkaktar).

2. Marrja e mostrave për praninë e dëmtuesit specifik

Mënyra e marrjes së mostrave për të kryer teste laboratorike për praninë e një dëmtuesi specifik do të varet nga qëllimi i testimit. Nisur nga kjo, testimi mund të kryhet, kur:

- a) ka simptoma dhe shenjat janë të dukshme; ose
- b) nuk ka simptoma të dukshme dhe testimi do kryhet për një infeksion të mundshëm të fshehtë.

a) Ka simptoma

Simptomat e infeksionit janë të dukshme dhe inspektori arrin në përfundimin se një dëmtues specifik mund të jetë agjenti shkaktar. Në një situatë të tillë, mjafton të merren disa bimë të infektuara (në fazë të ndryshme të zhvillimit të dëmtuesit), ose një pjesë të tyre, në mënyrë që të mundësohet testimi përkatës laboratorik (p.sh. filizat ose frutat e infektuara në rast të testimit për zjarrin bakterial “*Erwinia amylovora*”; gjethet simptomatike në rastin e testimit për *virusin e lujës së kumbullës*; rrënjët e bimëve që tregojnë ciste të



nematodave; mostra të insekteve në faza të ndryshme të zhvillimit etj.). Nëse është e mundur, rekomandohet që të merret e gjithë bima bashkë me rrënjët dhe dheun e ngjitur, kjo do ta mundësonte mbajtjen e materialit në një fazë të freskët për një kohë më të gjatë, por ndonjëherë ajo duhet të mbillet për ta lejuar rritjen e mëtejshme kur nevojitet testim më i gjatë.

Gjithashtu rekomandohet të sigurohen informacione të plota rreth situatës me operatorin profesionist përgjegjës për bimët, pasi nganjëherë informacionet thelbësore mund të merren nga diskutimi me operatorin profesionist, të tilla si d.m.th. probleme të ngjashme përreth; përdorimi i plehëruesve ose i PMB-ve; ndotja e ajrit; kushtet e pafavorshme klimatike etj.

b) Nuk ka simptoma

Nuk hasen bimë të prekura apo të dëmtuara (nuk ka simptoma), në këto raste ekziston nevoja për të bërë teste laboratorike për praninë e dëmtuesve specifikë për të kontrolluar nëse ata mund të jenë të pranishëm në formë të fshehtë. Kjo, për shembull, ka të bëjë me testimin e gungave të patates për praninë e *Clavibacter michiganensis* ssp. *sepedonicus* ose *Ralstonia solanacearum*; testimi i disa llojeve të materialit shumëzues të frutave për *virusin e liqës së kumbullës*; kontrollin e materialit shumëzues të manaferrave dhe luleshtrydhes për praninë e disa viruseve; testet e dheut për nematodat e cisteve të patateve; testimi i ujërave sipërfaqësore për *Ralstonia solanacearum* etj. Mënyra e marrjes së mostrës dhe madhësia e mostrës në situata të tilla do të varen nga lloji i bimës dhe lloji i dëmtuesit dhe në këtë rast do të zbatohen procedura specifike për dëmtuesit, të cilët marrin parasysh një marrëdhënie specifike ndërmjet një dëmtuesi dhe bimës/ve bujtëse të tij. Varësisht nga marrëdhënia e tillë, aktivitetet e kontrollit mund ta përfshijnë, për shembull, testimin e një madhësie specifike të mostrës (p.sh. 200 zhardhokë të marra nga çdo 25 tonë patate për lot); testimi i një proporcioni të caktuar të bimëve të kultivuara (p.sh. 5%); inspektimi i detajuar i një numri të caktuar të bimëve për praninë e dëmtuesve; përdorimi i feromoneve ose i kurtheve ngjitëse etj.

3. Marrja e mostrave për identifikimin e shkaktarit

Kjo situatë ndodh kur vërehen bimë të prekura, megjithatë është vështirë të vlerësohet përfun-

dimisht cili mund të jetë problemi që qëndron prapa kësaj. Në këtë situatë, gjëja e parë që duhet të bëhet është të vlerësohet nëse fajtori i mundshëm i përket apo nuk i përket një faktori biotik apo abiotik. Nëse inspektori dyshon se problemi mund të shkaktohet nga një faktor biotik, duhet të ngushtohet më tej një gamë e mundshme e agjentëve shkaktarë (p.sh. nëse ky mund të jetë problem viral, bakterial, mykologjik ose patogjenë tjetër). Në situata të tilla duhet të merren bimë të tëra, në faza të ndryshme të zhvillimit të dëmtuesit, bashkë me dheun ngjitur me të. Megjithatë, ndonjëherë mjafton të merret një mostër e cila do të përbëhet nga një pjesë specifike e bimës, si gjethet që do të testohen për viruse ose filiza, degë ose pjesë të tjera që e përfshijnë kufirin ndërmjet indit të shëndetshëm dhe të infektuar për ta testuar për baktere ose kërpudha (për ta mundësuar izolimin e një bakteri ose një kërpudhe).

Nëse dyshohet për infektim nga nematodat që vijnë nga dheu është e rëndësishme të merret një mostër dheu nga një zonë kufitare ndërmjet bimëve të prekura dhe atyre me pamje më të shëndetshme (ku përqendrimi i nematodave lëvizëse është më i madhi). Nëse vërehen insekte, mostra do të përbëhet nga faza të ndryshme të insekteve, por, gjithashtu, rekomandohet të merren edhe pjesët e infektuara të bimës.

Nëse inspektori nuk është në gjendje të vlerësojë fillimisht se cili mund të jetë agjenti shkaktar i problemit, duhet të merren disa bimë të prekura (në faza të ndryshme të zhvillimit të dëmtuesit) dhe gjithashtu të merren disa bimë që duken të shëndetshme për krahasim.

Duhet të shmanget marrja e mostrave të materialit plotësisht të dëmtuar ose të kalbur, pasi normalisht një përkeqësim i tillë është infeksion dytësor nga bakteret ose kërpudhat dhe e bën të pamundur gjetjen e shkaktarit fillestar të dëmtuesit.

Gjithashtu, në rast kur kanë dyshime, inspektorët duhet të kontaktojnë me përgjegjësit e tyre ose me stafin e laboratorit për të marrë ndihmë dhe këshilla se si të veprohet. Përdorimi i pajisjeve, si: aparatet fotografike ose celularët për të bërë fotografi dhe dërgimi i tyre për verifikim fillestar, është një mënyrë e mirë për të bërë të mundur ofrimin e udhëzimeve se si të vazhdohet më tej.

4. Konsiderata mbi ndjeshmërinë statistikore të metodave vrojtuese

Suksesi i programeve të vrojtimit varet nga



aftësia për të zbuluar dëmtuesit. Megjithatë, shpesh nuk mund të vëzhgohen të gjitha vendet e mundshme ose çdo bimë bujtëse në një zonë të caktuar ku mund të shfaqet një dëmtues. Përcaktimi i skemës së vrojtimit dhe metodat e marrjes së mostrave përdoren për të siguruar një nivel besueshmërie se dëmtuesi nuk është i pranishëm ose për të nxjerrë konkluzione rreth popullatës së dëmtuesve. Në lidhje me parimet e vrojtimit për zbulimin (praninë/mungesën e një dëmtuesi) kundrejt studimit për informacion (niveli i infektimit), duhet të merren parasysh elementet kyç, si më poshtë:

- “niveli i besueshmërisë” është niveli i saktësisë (besueshmërisë) në rezultate (konkluzione), kur thuhet se niveli i besueshmërisë është 95%, kjo nënkupton se, duke pasur parasysh metodat e përdorura, në 95% të rasteve ka siguri se kultura është “pa dëmtues”;

- “niveli i zbulimit” është shkalla më e vogël e infektimit me të cilën mund të zbulohet një dëmtues, duke pasur parasysh marrjen e mostrave dhe nivelin e besueshmërisë;

- “njësia e mostrës” është njësia bazë që inspektohet për të gjetur dëmtuesin; në varësi të rrethanave kjo mund të jetë një pemë, një gjethe e vetme, një kuti frutash ose një buqetë me lule;

- “madhësia e mostrimit” është numri i njësive të mostrës së inspektuar, p.sh. numri i kurtheve të vendosura në një fushë;

- “efikasiteti i mostrimit” është një normë ose përqindje që pasqyron saktësinë e inspektimeve; një efikasitet i ulët i mostrimit, duhet të rezultojë në një madhësi më të madhe të mostrës që çdo përfundim i deklaruar të jetë i saktë.

Shënim i rëndësishëm. Nuk mund të ketë kurrë 100% siguri se një zonë (ose popullata) është pa dëmtues, përveç nëse inspektohet 100% me efikasitet 100%. Ky standard është realisht i rrallë. Shprehja më e mirë është të thuhet se ka siguri (në një nivel besueshmërie) se një dëmtues është i pranishëm në një popullatë në më pak se një nivel zbulimi. Nëse një dëmtues nuk haset, atëherë ende ekziston një shkallë e pasigurisë në lidhje me bimët ose zonat që nuk janë ekzaminuar ose testuar. Një deklaratë statistikore e besueshmërisë, shpreh probabilitetin që prevalenca aktuale e dëmtuesve nuk do të jetë më shumë se niveli i zbulimit. Për shembull, pas mostrimit të një intervali besueshmërie prej 95% për një nivel zbulimi prej

0,01 do të thotë se ka një probabilitet 95% që prevalenca aktuale të jetë 0,01 ose më pak. Marrëdhënia midis nivelit të besueshmërisë dhe madhësisë së mostrës është e thjeshtë, sa më shumë vende të vrojtuar, aq më të sigurt mund të jenë rezultatet e zbulimit. Si rregull i përgjithshëm, një nivel besueshmërie prej të paktën 95% konsiderohet i pranueshëm, por në disa raste, një besueshmëri deri në 99,9% mund të jetë i nevojshëm. Për përzgjedhjen e bimëve brenda kulturave të zgjedhura, propozohet niveli 90%.

- Numri minimal i treguar i bimëve që do të kontrollohet duhet të lejojë zbulimin e të paktën 1% të infektimit.

Shembull i deklarimit të ekzaminimit vizual të një pemëtoreje me 1000 pemë për një dëmtues. Nëse inspektimet janë të gjitha negative, mund të bëhen deklaratat e mëposhtme:

- Nëse do të inspektohen 18 pemë, atëherë mund të thuhet me 95% besueshmëri, se shkalla e infektimit është më e vogël se 0,16 (16%);

- Nëse do të inspektohen 72 pemë, atëherë mund të thuhet me 95% besueshmëri se shkalla e infektimit është më e vogël se 0,04 (4%);

- Nëse do të inspektohen 86 pemë, atëherë mund të thuhet me 99% besueshmëri se shkalla e infektimit është më e vogël se 0,05 (5%);

- Nëse do të inspektohen 205 pemë, atëherë mund të thuhet me 95 % besueshmëri se shkalla e infektimit është më e vogël se 0,01 (1%).

SEKSIONI III

IDENTIFIKIMI, AMBALAZHIMI DHE DËRGIMI I MOSTRËS NË LABORATOR, TË MARRA PËR NGARKESAT PËR EKSPORT DHE NË IMPORT

1. Qëllimi i marrjes së mostrës në ngarkesa

Qëllimi i marrjes së mostrës në ngarkesë bëhet për inspektim dhe/ose testim në mënyrë që të:

- zbulojë dëmtuesit e rregulluar;
- garantojë se numri i dëmtuesve të rregulluar ose njësive të infektuara në një ngarkesë nuk e kalon kufirin e përcaktuar për dëmtuesit;
- garantojë sigurinë e gjendjes së përgjithshme fitosanitare të një ngarkese;
- zbulojë dëmtuesit për të cilët ende nuk është përcaktuar një risk fitosanitar;
- zgjedh probabilitetin e zbulimit të dëmtuesve specifikë të rregulluar;



- maksimizojë përdorimin e burimeve të mundshme të mostrimit;
- mbledh informacione të tjera, si për monitorimin e një shtegu;
- verifikojë pajtueshmërinë me kërkesat fitosanitare;
- përcaktojë proporcionin e ngarkesës së infektuar.

Inspektimi dhe/ose testimi i bazuar në marrjen e mostrave gjithmonë përfshin një shkallë gabimi. Pranimi i një probabiliteti që dëmtuesit janë të pranishëm, është i natyrshëm në përdorimin e procedurave të marrjes së mostrave për inspektim dhe/ose testim. Inspektimi dhe/ose testimi me bazë statistikore mund të sigurojë një nivel besueshmërie se incidenca e një dëmtuesi është nën një nivel të caktuar, por nuk provon që një dëmtues nuk është i pranishëm në një ngarkesë.

2. Identifikimi i lotit

Një ngarkesë mund të përbëhet nga një ose më shumë lote. Kur një ngarkesë përmban më shumë se një lot, inspektimi për të përcaktuar përputhshmërinë mund të përbëhet nga disa ekzaminime vizuale të ndara, dhe prandaj lotet do të duhet të mostrohen veçmas. Në raste të tilla, mostrat në lidhje me secilin lot duhet të jenë të veçuara dhe identifikuar në mënyrë që loti i duhur të identifikohet qartë nëse inspektimi pasues ose testimi zbulon mosrespektimin e kërkesave fitosanitare.

Nëse do të inspektohet një lot apo jo, duhet të përcaktohet duke përdorur faktorët e përcaktuar në pikën 5, të seksionit 1 të këtij kreu.

Për marrjen e mostrës në një lot, duhet të jetë një numër njësisish të një malli të vetëm të identifikueshëm nga homogjeniteti i tij, në faktorë të tillë si:

- origjina;
- kultivuesi;
- ambienti për ambalazhim;
- speciet, larmia ose shkalla e maturimit;
- eksportuesi;
- zona e prodhimit;
- dëmtuesi i rregulluar dhe karakteristikat e tij;
- trajtimi në origjinë;
- lloji i përpunimit.

Kriteret e përdorura për të përcaktuar lotet duhet të zbatohen vazhdimisht për objektet për inspektim fitosanitar, të ngjashme.

3. Ambalazhimi i mostrës dhe dërgimi i tij në një laborator

Kategoritë dhe kriteret për ambalazhimin e mostrës, për të siguruar që një mostër është e përshtatshme për testim pas mbërritjes në laborator, janë si më poshtë:

Bimë e plotë: sistemi rrënjor futet në një qese plastike të mbyllur rreth kërcellit të bimës. Vendoset e gjithë bima në një qese të dytë plastike, fryhet pak ajër dhe mbyllet.

Gjethet dhe lastarët: diagnoza e virusit – vendoset në një qese plastike sterile, fryhet pak me ajër dhe mbyllet.

Diagnoza të tjera të papërcaktuara: – mbështillet mostra me letër thithëse pak të lagur me ujë të distiluar, vendoset në një qese plastike sterile, fryhet pak me ajër dhe mbyllet.

Artikujt e freskët: fruta, perime, zhardhokë (përveç patateve), bulbat, frutat rrënjor etj. – mbështillen në të thatë me letër thithëse, në paketim individual për të shmangur kalbëzimin/thyerjen gjatë transportit. Vendosen në një qese plastike, fryhen pak me ajër dhe mbyllen.

Dëmtuesit jovertebrorë: mostrat ose ekzemplarët e dëmtuesve jovertebrorë (insekte, merimanga, këpushat etj.) duhet të vendosen në një enë plastike ose tub plastik të mbyllur.

Zhardhokët e patates: diagnoza jovertebrorë – mbështillet me letër të thatë thithëse. Vendoset në një qese plastike sterile, fryhet pak me ajër dhe mbyllet.

Diagnoza të tjera të papërcaktuara: – mbështillet me letër thithëse të thatë. Mos e vendosni në qese plastike!

Mostrat e tokës: për analizën e nematodës vendoset sasia e nevojshme e dheut në një qese plastike të fortë dhe mbyllet.

Të gjitha mostrat duhet të vendosen në një kuti kartoni të fortë dhe të mbyllur. Çdo material i gjallë duhet të dorëzohet në laborator sa më shpejt të jetë i mundur, në shumicën e rasteve duhet të ruhet në ambiente të ftohta (boks frigoriferik), por jo në ngrirje. Dërgimi i mostrave duhet të shmanget pak para fundjavave ose festave zyrtare. Nëse dërgohen me postë ose kompani korrierë, kutia do të shënohet si “*bimë të gjalla*” dhe do të dërgohen si ngarkesa të shpejta.

4. Dokumenti shoqërues i mostrës

1. Të gjitha mostrat që dërgohen për testim në laborator për shëndetin e bimëve duhen të



shoqërohen me “Fletë shoqërimi mostre për testim”, sipas pjesës A, të aneksit VI, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Fleta e shoqërimit të mostrës për testim mbahet në dy kopje, një kopje shoqëron mostrën për testim në laborator dhe një kopje e mban inspektori. Të dyja kopjet të firmosen nga dorëzuesi dhe pranuesi i mostrës. Në rast të mospranimit të mostrës nga laborator, laborator duhet të specifikojë arsyet e mospranimit të fleta e shoqërimit të mostrës.

SEKSIONI IV

MARRJA E MOSTRAVE PËR KONTROLLET NË PIKAT E INSPEKTIMIT KUFITAR PËR NGARKESAT NË IMPORT DHE DËRGIMI NË LABORATOR

1. Identifikimi i lotit dhe njësisë së mostrës

Identifikimi i lotit për inspektim në pikat e kalimit kufitar bëhet sipas pikës 2, të seksionit IV, të këtij kreu, ndërsa marrja e mostrës së pari përfshin identifikimin e njësisë së përshtatshme për marrjen e mostrës (*për shembull*: një frutë, kërcell, tufë, njësia e peshës, çanta ose kartoni). Përcaktimi i njësisë së mostrës ndikohet nga çështjet që lidhen me:

- homogjenitetin e shpërndarjes së dëmtuesit nëpërmjet ngarkesës;
- fazën e dëmtuesit (nëse është në fazën e qetësisë ose aktive);
- ambalazhimin e ngarkesës;
- destinacionin e ngarkesës, qëllimin e përdorimit;
- konsideratat operacionale.

Nëse përcaktohet vetëm nga biologjia e dëmtuesve, njësia e duhur e mostrës mund të jetë një bimë ose produkt bimor individual në rastin e një dëmtuesi me lëvizshmëri të ulët, ndërsa në rastin e dëmtuesve të lëvizshëm, një kuti kartoni ose një enë tjetër mallrash mund të jetë e përshtatshme për mostrën. Kur inspektimi duhet të zbulojë më shumë se një lloj dëmtuesish, mund të zbatohen faktor të tjerë (p.sh. praktika e përdorimit të njësive të ndryshme të mostrës). Njësitë e mostrës duhet të përcaktohen vazhdimisht dhe të pavarura nga njëra-tjetra.

2. Mostrim statistikor dhe jostatistikor

Metoda e marrjes së mostrave është procesi i caktuar nga institucioni përgjegjës për të zgjedhur njësitë për inspektim dhe/ose testim. Marrja e mostrës për inspektimin fitosanitar të ngarkesave

ose loteve bëhet duke marrë njësi nga ngarkesa ose loti pa zëvendësuar njësitë e zgjedhura¹.

Marrja e mostrës bazuar në metodat statistikore ose të synuara është përcaktuar për të lehtësuar zbulimin e një dëmtuesi/ve të rregulluar në një ngarkesë ose lot.

2.1 Mostrim i bazuar statistikisht

Metodat e mostrimit të bazuar statistikisht përfshijnë përcaktimin e një numri të parametrave të ndërlidhur dhe zgjedhjen e metodës më të përshtatshme të mostrimit të bazuar statistikisht.

2.1.1 Parametrat dhe konceptet e lidhur

Mostrimi i bazuar statistikisht është përcaktuar për të zbuluar një përqindje ose përqindje të caktuar të infektimit me një nivel specifik të besueshmërisë, për përcaktimin e parametrave të mëposhtëm:

- a) niveli i pranimit;
- b) niveli i zbulimit;
- c) niveli i besueshmërisë;
- d) efikasiteti i zbulimit; dhe
- e) madhësia e mostrës.

2.1.1.1 Numri i pranimit

Numri i pranimit është numri i njësive të infektuara ose numri i dëmtuesve individualë që janë të lejueshëm në një mostër të një madhësie të caktuar përpara se të ndërmerren veprime fitosanitare.

Kështu, nëse numri i pranimit është zero dhe një njësi e infektuar zbulohet në mostër, do të ndërmerren masa fitosanitare. Është e rëndësishme të vlerësohet se një numër zero pranimi brenda një mostre nuk nënkupton një nivel zero tolerance në ngarkesë në tërësi, edhe nëse nuk zbulohen dëmtues në mostër, ekziston një probabilitet që dëmtuesi të jetë i pranishëm në pjesën e mbetur të ngarkesës, megjithëse në një nivel shumë të ulët.

Numri i pranimit është i lidhur me mostrën. Numri i pranimit është numri i njësive të infektuara ose numri i dëmtuesve individualë që lejohen në mostër, ndërsa niveli i tolerancës (shih pikën 2.1.1.6, të këtij seksioni) i referohet statusit të të gjithë ngarkesës.

¹ Marrja e mostrës pa zëvendësim është zgjedhja e një njësie nga ngarkesa ose loti pa zëvendësuar njësinë përpara se të zgjidhen njësitë e ardhshme. Marrja e mostrës pa zëvendësim nuk do të thotë se një mall i zgjedhur nuk mund të kthehet në një ngarkesë (përveç mostrimit shkatërrues), do të thotë vetëm se inspektori nuk duhet ta kthejë atë përpara se të zgjedhë pjesën e mbetur të mostrës.



2.1.1.2 Niveli i zbulimit

Niveli i zbulimit është përqindja e infektimit minimal që metoda e përdorur e marrjes së mostrave do të zbulojë në efikasitetin e specifikuar të zbulimit dhe nivelin e besueshmërisë, që synohet të zbulojë në një ngarkesë.

Niveli i zbulimit mund të specifikohet për një dëmtues, një grup ose kategori dëmtuesish ose për dëmtuesit e papërcaktuar. Niveli i zbulimit rrjedh nga:

- një vendim i bazuar në analizën e riskut të dëmtuesve për të zbuluar një nivel të specifikuar të infektimit (infektimi i vendosur për të paraqitur një risk të papranueshëm);
- një vlerësim të efektivitetit të masave fitosanitare të aplikuara para inspektimit;
- një vendim i bazuar në mënyrë operacionale që intensiteti i inspektimit mbi një nivel të caktuar nuk është praktik.

2.1.1.3 Niveli i besueshmërisë

Niveli i besueshmërisë tregon mundësinë që të zbulohet një ngarkesë me një shkallë infektimi që tejkalon nivelin e zbulimit. Rekomandohet të përdoret një nivel besueshmërie prej 95%. Niveli i besueshmërisë mund të jetë i ndryshëm, në varësi të përcaktimit të përdorimit. Për shembull, mund të kërkohej një nivel më i lartë besueshmërie zbulimi, për bimët për mbjellje, krahasuar me produktet për konsum. Niveli i besueshmërisë mund të ndryshojë, gjithashtu, nga fuqia e masave fitosanitare të aplikuara dhe historiku i të dhënave të mospërputhjes. Vlerat e nivelit shumë të lartë të besueshmërisë bëhen shpejt të vështira për t'u arritur dhe vlerat më të ulëta bëhen më pak kuptimplote për vendimmarrje.

Niveli i besueshmërisë prej 95% do të thotë se konkluzionet e nxjerra nga rezultatet e marrjes së mostrave do të zbulojnë një ngarkesë që nuk është në përputhje mesatarisht 95 herë nga 100, dhe për këtë arsye, mund të supozohet se mesatarisht 5% e ngarkesave që nuk janë në përputhje nuk do të zbulohen.

2.1.1.4 Efikasiteti i zbulimit

Efikasiteti i zbulimit është probabiliteti që një inspektim ose testim i një njësie të infektuar do të zbulojë një dëmtues. Në përgjithësi, efikasiteti nuk rekomandohet të supozohet të jetë 100%. P.sh. dëmtuesit mund të jenë të vështirë për t'u zbuluar me ekzaminimin vizual sepse bimët mund të mos shfaqin simptoma “asimptomatike” (infeksion i

fshehtë) ose efikasiteti mund të reduktohet si rezultat i gabimit njerëzor. Mund të përfshihen vlera më të ulëta të efikasitetit (p.sh. një besueshmëri 80% për të zbuluar dëmtuesin kur inspektohet një njësi e infektuar) në përcaktimin e madhësisë së mostrës.

2.1.1.5 Madhësia e mostrës

Madhësia e mostrës është numri i njërive të zgjedhura nga loti ose ngarkesa që do të inspektohet ose testohet. Udhëzimet për përcaktimin e madhësisë së mostrës janë dhënë në anekset II, III, IV dhe V, bashkëlidhur këtij urdhri.

2.1.1.6 Niveli i tolerancës

Niveli i tolerancës i referohet përqindjes së infektimit në të gjithë ngarkesën ose lotin, ky është kufiri kritik për masa fitosanitare.

Kufiri kritik për dëmtuesit jokarantinorë të rregulluar (DJKRR), është sipas nenit 5, të kreut II, të urdhrit nr. 113, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar.

Kufiri kritik për dëmtuesit karantinorë bazuar në legjislacionin është zero, pra nuk lejohet prania e tyre në ngarkesat e destinuara për kontrollin fitosanitar. Nëse zbulohet një mostër e infektuar me dëmtues karantinorë do të ndërmerren masa fitosanitare sipas legjislacionit në fuqi.

2.1.2 Lidhjet midis parametrave dhe nivelit të tolerancës

Pesë parametrat (numri i pranimit, niveli i zbulimit, niveli i besueshmërisë, efikasiteti i zbulimit dhe madhësia e mostrës) janë statistikisht të lidhura.

Nëse niveli i tolerancës është më i madh se zero, niveli i zbulimit të zgjedhur duhet të jetë i barabartë me (ose më pak nëse numri i pranimit është më i madh se zero) me nivelin e tolerancës për të siguruar që ngarkesa të ketë një nivel infektimi më të madh se niveli i tolerancës, i cili do të zbulohet me nivelin e specifikuar të besueshmërisë.

Nëse nuk zbulohen dëmtues në njësinë e mostrës, atëherë përqindja e infektimit në ngarkesë nuk mund të deklarohet përtej faktit, se bie nën nivelin e zbulimit në nivelin e deklaruar të besueshmërisë. Nëse dëmtuesi nuk zbulohet me madhësinë e duhur të mostrimit, niveli i besueshmërisë jep një probabilitet që niveli i tolerancës të mos tejkalohet.

2.1.3 Metodatat e mostrimit bazuar statistikisht



2.1.3.1 Mostrimi i thjeshtë i rastësishëm

Mostrimi i thjeshtë i rastësishëm, rezulton në të gjitha njësitë e mostrës që kanë një probabilitet të barabartë për t'u zgjedhur nga loti ose ngarkesa. Mostrimi i thjeshtë i rastësishëm, përfshin mënyrën nxjerrjes së njësite të mostrës përfaqësuese në përputhje me një tabelë numrash (shirash) të rastësishëm. Përdorimi i një procesi të rastësishëm të paracaktuar është ajo që e dallon këtë metodë nga mostrimi gjysmërastësor (përshkruar në pikën 2.2.2, të këtij seksioni).

Kjo metodë përdoret kur dihet pak për shpërndarjen e dëmtuesve ose shkallën e infektimit. Mostrimi i thjeshtë i rastësishëm mund të jetë i vështirë për t'u zbatuar saktë në situata operacionale. Për të përdorur këtë metodë, secila njësi duhet të ketë një probabilitet të barabartë të zgjedhjes. Në rastet kur një dëmtues nuk shpërndahet rastësisht përmes lotit, kjo metodë mund të mos jetë një mundësi. Mostrimi i thjeshtë i rastësishëm mund të kërkojë burime më të mëdha sesa mostrimet me metodat e tjera. Kërkesa mund të varet nga lloji dhe/ose konfigurimi i ngarkesës.

2.1.3.2 Mostrim sistematik

Marrja e mostrës sistematike, përfshin mënyrën e nxjerrjes së një mostre përfaqësuese nga njësitë në lot në intervale fikse, të paracaktuara. Megjithatë, zgjedhja e parë duhet të bëhet në mënyrë të rastësishme përmes lotit. Rezultatet e njëanshme janë të mundshme nëse dëmtuesit shpërndahen në një mënyrë të ngjashme me intervalin e zgjedhur për marrjen e mostrës.

Dy avantazhe të kësaj metode janë që procesi i marrjes së mostrës mund të automatizohet përmes makinerive dhe kjo kërkon përdorimin e një procesi të rastësishëm vetëm për të zgjedhur njësinë e parë.

2.1.3.3 Mostrim i shtresëzuar

Marrja e mostrës të shtresëzuar, përfshin ndarjen e lotit në nëndarje të veçanta (d.m.th., shtresa) dhe më pas nxjerrje e njësite të mostrës përfaqësuese nga çdo nëndarje. Brenda secilës nëndarje, njësitë e mostrës merren duke përdorur një metodë të veçantë (sistematike ose e rastësishme). Në disa rrethana, numra të ndryshëm të njësite të mostrës mund të merren nga secila nëndarje; p.sh. numri i njësite të mostrës mund të jetë proporcional me madhësinë e nëndarjes ose bazuar në njohuritë paraprake në lidhje me infektimin e nëndarjeve.

